Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

PRISHTINA

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 44 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe nenit 38, paragrafi 38.2 i Statusit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.20210 dhe nenit 6 të Udhëzimit administrativ (MAPL), nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, me inicimin e Kryetarit të Kryeqytetit, kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit,

th ë rr e t

seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, e cila do të mbahet më **6.11.2026** dhe do të fillojë në orën **10:00.**

Seanca do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Kryeqytetit, rr. "UÇK", nr. 2.

Për seancë propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik – 30 shtator 2026 (TM3);
2. Propozim-vendimi i Rregullores për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve në komunën e Prishtinës;
3. Propozim-vendimi për vënie në diskutim publik të projektrregullores për procedurat e bashkinvestimit ndërmjet ndërmarrjeve publike lokale të Kryeqytetit dhe sektorit privat;
4. Propozim-vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për bashkëpunim operacional dhe shërbimet tjera me UNDP-në;
5. Propozim-vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);
6. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për projektin "Art-Tek Qendra";
7. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për projektin "Fushat e futbollit" në Sofali";
8. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për projektin "Shkolla e Arteve Pamore dhe Performuese";
9. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për projektin "Ulpiana 2030 Legacy";

10. Propozim-vendimi për subvencionimin e projektit kulturor artistik "Nënë Tereza";
11. Propozim-vendimi për caktimin e anëtarëve të komisioneve për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në Kryeqytet.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-060/01-164876/26, më 3.11.2026

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina